



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:136868
Datë: 23.10.2024
Numri i dokumentit: 06340314

CAP.nr.970/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtaren Mevlide Kosumi Qarri, në çështjen juridike përmbarimore të kreditores të përmbarimit Y. A., e përfaqësuar me autorizim nga S. K.avokat në Prishtinë, kundër debitorit SHSKUK-QKUK, në Prishtinë, lidhur me çështjen përmbarimore pagesa e pagave jubilarë, në shumën prej 905.34 €, si objekt i përmbarimit, në bazë të dokumentit përmbarues, duke vendosur lidhur me ankesën e përfaqësuesit të kreditores të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë PPP.nr.1817/2020, të datës 28.05.2021, me datë 23.10.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e themeltë ankesa e kreditorit të përmbarimit Y. A., e përfaqësuar me autorizim nga S. K., avokat në Prishtinë, PRISHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i përgjithshëm, PPP.nr.1817/2020, të datës 28.05.2021, dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në procedim të serishëm.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë- me aktvendimin PPP.nr.1817/2020 të datës 28.05.2021, e ka konsideruar të tërhequr, propozimin për përmbarim të kreditores Y. A., në lëndën PPP.nr.1817/20, të lejuar me urdhrin përmbarimor të përmbaruesit privat PPP.nr.1817/20 me datë 28.05.2020 dhe abrogohen të gjitha veprimet e ndërmarra përmbarimore.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë përfaqësuesi i kreditores, për shkak shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke propozuar që të aprovohet ankesa e parashtruar si e bazuar, dhe të prishet aktvendimi i ankimuar, të lihet në fuqi urdhri përmbarimor P.nr.1302/20 të datës 28.05.2020, dhe detyrohet debitori që në emër të shpërblimit

jubilar t'ia paguaj kreditorit shumën si në urdhër për përmbarim si dhe të gjitha shpenzimet procedurale dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar debitori.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 lidhur me 194 të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), gjeti se:

- Ankesa e debitorit është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se përfaqësuesi i kreditorës Y. A., me datën 22.05.2020 ka paraqitur propozim për përmbarim në bazë të titullit ekzekutiv vendimi i inspektoratit të punës nr.01.... të datës 10.02.2020 dhe vendimit nr. 3.... të datës 19.05.2020, kundër debitorit të përmbarimit SHSKUK-QKUK me seli në Prishtinë, ndërsa përmbaruesi privat me urdhrin P.nr.1302/20, të datës 28.05.2020, e ka lejuar ekzekutimin në bazë të titulli ekzekutiv, për pagesën e borxhit në shumë prej 905.34 €, dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore .

Kundër urdhrin për përmbarim debitori me datë 08.06.2020 ka ushtruar prapësim. Gjykata e shkallës së parë me Konkluzion PPP.nr.1817/20, të datës 14.04.2021, ka urdhëruar kreditorin, që në afat prej 3 (tre) ditëve nga dita e pranimit të konkluzionit, të dorëzojë në origjinal apo në kopje të vërtetuar sipas ligjit (të noterizuar) dokumentin përmbarues-vendimi i Inspektoratit të Punës Nr.01/21-1178 i datës 18.11.2020, të pajisur me klauzolën e plotfuqishmërisë dhe ekzekutueshmërisë. Gjykata e shkallës së parë me Aktvendim PPP.nr.1817/20 të datës 28.05.2021 e ka konsideruar të tërhequr propozimin e kreditorës Y. A., në lëndën PPP.nr.1817/20, i ushtruar te përmbaruesi privat A. M. me datë 28.05.2020 dhe abrogohen të gjitha veprimet e ndërmarra përmbarimore. Në arsyetim të këtij aktvendimi gjykata ka theksuar se edhe pas kalimit 3 ditor nga data e marrjes së konkluzionit ku kreditori e ka pranuar me datë 22.04.2021, dëshmi fletedërgesa në shkresat e lëndës, kreditori nuk ka vepruar në bazë të konkluzionit, gjykata ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 102.3 të LPK-së.

Gjykata e Apelit duke u bazuar nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, për shkak se aktvendimi i atakuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.1 të LPK-së, lidhur me nenin 70 të LPP-së.

Gjykata e shkallës së parë gabimisht ka bërë konstatimin e faktit se kreditorja nuk e dorëzuar brenda afatit ligjor parashtresën sipas konkluzionit. Nga shkresat e lëndës, në bazë të fletedërgesës, vërtetohet se përfaqësuesi i kreditorit konkluzionin e ka pranuar me datë 22.04.2021 dhe i njëjti parashtresën sipas konkluzionit e ka dorëzuar përmes postes me datën 24.04.2021, që do të thotë brenda afatit të paraparë për dorëzimin e parashtresës. Përkundër këtij fakti, në aktvendimin ankimor gabimisht është konstatuar se deri në datën e marrjes së Aktvendimit PPP.nr.1817/20 të datës 28.05.2021(kanë kaluar më tepër se një muaj)kreditori nuk

ka vepruar sipas konkluzionit dhe për këto arsye e ka konsideruar të tërhequr propozimin për përmbarrim të kreditorit. Edhe nëse eventualisht mund të bëhet fjalë për ndonjë ngatërresë në përcjelljen e kësaj parashtrere në shkresat e lëndës, megjithatë një gjë e tillë nuk bie nën përgjegjësinë e palës kreditore, e cila nuk e ka bërë ndonjë lëshim në dorëzimin e parashtrës brenda afatit ligjor, andaj nuk mund t'i bartë edhe pasojat për një situatë të tillë. Çfarëdo lëshimi eventual nga ana e gjykatës së shkallës së parë, përkatësisht administratës së gjykatës lidhur me komunikimin e shkresës për dorëzimin e parashtrës që ka ndikuar në konstatimet e gabuara lidhur me dorëzimin e parashtrës nga ana e kreditorit, e si rezultat i kësaj, nuk ka pasur hapësirë për aplikimin e dispozitave nga neni 102.3 i LPK-së, kur është konsideruar i tërhequr propozimi për përmbarrim.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit gjeti se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave të lartcekura, të cilat duhet të eliminohen në riprocedurë, në atë mënyrë që meqë parashtrera sipas konkluzionit është dorëzuar brenda afatit të caktuar nga gjykata, të vazhdojë procedurën në mënyrë të rregullt, të ndër marrë veprime tjera procedurale me qëllim të shqyrtimit efikas të kësaj çështjeje juridike, rrjedhimisht krijimit të kushteve për nxjerrjen e një vendimi të drejtë dhe të ligjshëm. Në çdo rast veprimet dhe vendimet e gjykatës duhet të jenë në harmoni me dispozitat ligjore dhe standardet e gjykimit të drejtë.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se *"Në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual"*.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 208, 209 pika d) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CAP.nr.970/2023, datë 23.10.2024

Gjyqtarja
Mevlide Kosumi Qarri